

STRATEGJIA PËR ZGJERIM E KE-SË DHE SFIDAT KRYESORE VITI TË VITIT 2014-2015:

Procesi i aderimit drejt BE-së është në ngecje. Duhet të ndërmerret veprim për të ndaluar ngecjen, posaçërisht në lidhje me lirinë e të shprehurit dhe të mediave, si dhe në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Komisioni kërkon nga autoritetet të ndërmarrin masa serioze për të adresuar rritjen e politizimit dhe mangësitë në rritje të paanshmërisë së gjyqit dhe lirisë së shprehjes, me qëllim që rekomandimi t'i përmbahen edhe në të ardhmen.

NGA RAPORTI I KOMISIONIT EVROPIAN PËR VITIN 2014:

DEMOKRACI DHE SUNDIMI I TË DREJTËS

1. Partitë në pushtet janë bërë një lloj të barabartë me shtetin, që ka krijuar një mosbesim plotësues në institucionet.
2. Ka një kontroll serioz qeveritar mbi mediet dhe institucionet.

KUSHTETUTË DHE GJYKATA KUSHTETUESE

1. Brengos ajo që ndryshimi i përbërjes së Gjykatës Kushtetuese gjatë viteve të fundit ndikon mbi pavarësinë, veçanërisht nga fakti që gjithnjë më tepër vonohen vendimet dhe bëhen kompromise të çuditshme në vendimet.
2. Në janar 2014, Gjykata Kushtetuese refuzoi iniciativën për të caktuar kushtetutshmërinë e buxhetit kontrovers të vitit 2013, pasi që paraprakisht tepër gjatë ka anuluar debatin për lëndën për arsye të çështjeve teknike.
3. Gjykata Kushtetuese refuzoi iniciativën për caktimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Lustrim kontrovers ndonëse më para kanë kërkuar dhe marrë mendim për atë çështje nga Komisioni i Venedikut.

ZGJEDHJE

1. ODHIR njoftoi mbi dëshmitë e besueshme për ndarje të pamjaftueshme mes shtetit dhe partisë politike, si dhe për shtypje mbi nëpunësit shtetëror.
2. ODHIR tregoi që shumica e medimeve mbështesin më tepër Qeverinë, përfshirë edhe servis kombëtar.
3. Në njoftimin e tyre, mediet nuk kanë bërë dallim nëse prezantojnë ministër (përfaqësues zyrtar të qeverisë) ose kandidat për deputet.

KUVEND

1. Nga gjitha 399 ligjet e miratuara gjatë kësaj periudhe raportuese, 175 janë miratuar me procedurë të shkurtë.
2. Puna e Kuvendit është vështirësuar për shkak të mungesës së dialogut politik dhe për shkak të ndarjes së thellë mes partive politike.



QEVERI

1. Duhet të ndërmerren aktivitete për tejkalimin e problemeve të theksuara nga OBSE/ODHIR për shkak të kufizimit të shtetit dhe partive në pushtet.
2. Qeveria duhet të funksionojë më mirë dhe në mënyrë unitare që të jetë proaktive në ndërmarrjen e masave të përbashkëta që do të zmadhojnë besimin e gjitha komuniteteve.

REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

1. Besimi në pavarësinë e institucioneve shtetërore është i ultë.

2. Politizimi i administratës publike si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal mbetet një problem serioz.
3. Disa punësime më tepër i ngjajnë një mase sociale sesa përgjigje e nevojave të institucionit.
4. Transparenca dhe qasja ndaj informacioneve publike mbeten akoma të ultë.

SHOQËRIA QYTETARE

1. Strategjia qeveritare për bashkëpunim me sektorin qeveritar zbatohet në mënyrë joadekuate për shkak të mungesës së vullnetit politik, kapaciteteve administrative dhe resurseve.

SISTEMI GJYQËSOR

1. Duhet jo vetëm një pavarësi strukturore por edhe funksionale të gjykatësve, që do të përmirësojë cilësinë e drejtësisë dhe standardeve të shërbimeve që ju ofrohen qytetarëve.
2. Më tutje do të hapen çështjet në vend dhe jashtë vendit për ndikime politike mbi disa procese gjyqësore.
3. Vazhdojnë pohimet për ndikim indirekt politik mbi sjelljen e gjykatësve dhe mbi rezultatit e procedurave gjyqësore të nivelit të lartë, veçanërisht në lidhje me akuzat për krim të organizuar dhe korrupsion, si dhe për rastet në të cilat janë përfshirë politikanë dhe medie.
4. Secili gjykatës duhet të dëshmojë që në praktikë vepron pavarësisht nga çfarëdo forme të shtypjes sepse përndryshe besimi publik do të humbet ndërsa sundimi i të drejtës do të vihet në pikëpyetje.
5. Duhet masa të përforcuara që do të garantojnë që emërtimet e gjykatësve dhe avancimet janë të bazuara në sistem të meritave.
6. Kriteri ligjor, sipas të cilës gjykatësit e nivelit më të lartë duhet të kenë përvojë gjyqësore, ishte injoruar në shumë emërime të bëra në prag të sjelljes së amendamentit me të cilën ky kriter duhet të hyjë në fuqi, ndërsa për disa emërime, ky kriter ishte injoruar edhe pas hyrjes në fuqi.


POLITIKË PËR LUFTË KUNDËR KORRUPSIONIT

1. Politikat e ardhshme duhet të kanë për qëllim zgjedhjen e fushave problematike, duke përfshirë edhe prokurimet publike, korrupsionin politik dhe korrupsionin e nivelit të lartë.
2. Urgjentisht duhen masa për ngritjen e vetëdijes dhe vullnetit politik.
3. Mbeten pohimet për zbatimin selektiv të ligjeve dhe ndikimin politik.
4. Kapaciteti i plotë i gjykatave të merret me raste të korrupsionit mbetet i dobët, veçanërisht në rastet e nivelit të lartë, ku procedurat janë të gjata dhe joefikase.

5. Brengos mungesa e transparencës dhe përgjegjësisë së partive politike në lidhje me financimin e tyre.
6. Korrupsioni në prokurimet publike mbetet një problem serioz.

LIRIA E SHPREHJES

1. Liria e shprehjes vazhdon të jetë mjaft problematike.
2. Duke përdorur fushatat reklamuese dhe mediet përkatëse, Qeveria realizon kontroll indirekt mbi mediet.
3. Servisi publik radiodifuz nuk e kryen rolin e tij mjaftueshëm për sigurimin e informimit të baraspeshuar dhe objektiv.
4. E gjithë kjo rezulton me mungesën e informimit të vërtetë, të saktë dhe objektiv që publiku duhet të merr nga mediet tradicionale.
5. Paditë për fyerje dhe shpifje janë veprim standard të gazetarëve kundër gazetarëve (duke treguar nivelin e ultë të solidaritetit në profesion), të politikanëve kundër gazetarëve (që shkel lirinë e shprehjes) dhe të politikanëve kundër politikanëve (në vend që të realizohet debat i hapur).
6. Gjykimet me cilat arsyetohen kërkesat e padive janë të vogla, ndërsa gjykatësit janë konservativ në caktimin e dënimeve. Megjithatë ka përjashtime, duke përfshirë edhe raste që kanë përfshirë persona publik. E gjithë kjo dërgon një mesazh të keq për lirinë e të folurit dhe për pavarësinë e gjyqësorit.



POLITIKA PËR ANTIDISKRIMINIM

1. Duhet bërë përpjekje serioze për përfundimin e vetëdijes së publikut mbi respektimin e llojllojshmërisë së shoqërisë dhe t'i përgjigjet mungesës së tolerancës që zgjerohet nga disa medime dhe nëpërmjet rrjeteve sociale.
2. Të dhënat për njoftime, hetime dhe akt-akuzat të parashtruara për të folurit e urretjes dhe për vepra kriminale të bëra nga urretjtja nuk mblidhen në mënyrë sistemore, ndërsa trajnimi i policisë, prokurorisë dhe gjykatave duhet të përforcet.
3. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi duhet të jetë e përpunuar me të drejtën e BE-së që do të përfshihen edhe diskriminim në bazë të orientimit seksual.

